



# SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT JANAR- QERSHOR

VITI 2016

## I. Përmbledhje ekzekutive

Funksioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe atë të subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.

Sektori ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) gjatë periudhës Janar – Qershor 2016 ka ushtruar veprimtarinë e tij në 8 subjekte nga 9 subjekte të planifikuara, **realizimi i planit është 88.8 % si 6 mujor.**

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara ka vlerësuar një nivel të lartë risku në sistemin e kontrollit të brendshëm, në sistemin e prokurimeve publike, sistemet e menaxhimit financiar, menaxhimin e aktiveve .

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjenerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve.

Struktura e miratuar e Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë SHSSH është e përbërë nga 3 vetë.

Gjatë periudhës Janar Maj 2016 kjo strukturë ka funksionuar me dy auditues, në muajin Qershor struktura është plotësuar me 3 veta.

**Audituesit janë të certifikuar dhe kualifikuar në përputhje** me nenin 19 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

## II. Baza ligjore

Auditimi i brendshëm ka një bazë ligjore dhe procedurale e cila përfaqësohet nga: Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është ligji nr. 114, datë 22.10.20105 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Baza ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe institucionet e varësisë janë:

- Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005, “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar,
- \_Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”,
- \_Ligji Nr.8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”
- \_Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit”
- \_Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për programin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

### III Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësi të tyre. Këtë mision ai e realizon duke:

1. Duke kryer vlerësime të pavarura të sistemeve, bazuar në standartet profesionale të miratuara.
2. Duke lënë rekomandime për përmirësimin e sistemeve
3. Ngritur nivelin profesional të audituesve.

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH dhe 23 subjekte të varësisë, si më poshtë:

- a) Drejtori brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej 6 Drejtori.
- b) Drejtori Rajonale 12,
- c) Shtëpi Fëmije, 3
- d) Qendra Zhëllimi, 2
- e) Shtëpi të të Moshuarve, 2
- f) Qendër Ditore për të Moshuarit 1
- g) Qendra për persona të dhunuar dhe të trafikuar. 3

Gjithashtu auditon dhe 17 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të cilat janë në varësi strukturore të pushtetit vendor.

### IV Rezultatet e veprimtarisë së AB

- **Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.**

Nga misionet e ushtruara në subjektet e varësisë janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuar dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.

**1- Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit konsiderohet si sistem me risk të lartë që lidhen kryesisht me mangësi e parregullsi në:**

**A- planifikimin e buxhetit.** Nga auditimi konstatohet se hartimi i projekt buxhetit kryhet nga nëpunësi zbatues dhe jo nga një grup pune i ngritur për këtë qëllim si përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

Planifikimi i nevojave për mallra e shërbime për funksionimin e veprimtarisë nuk bëhet i detajuar, gjë që përbën bazën e hartimit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike.

**B- zbatimin e buxhetit** në lidhje me:

**i- mangësi në justifikimin e shpenzimeve të kryera me dokumentacionin autorizues e vërtetues,**

**ii- mos respektim në kohë të deklarimit dhe kryerjen e pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimin**

**iii- likuidimin e shpenzimeve pa marrë në dorëzim mallin e shërbimin në kundërshtim me Udhëzimin 30 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.**

**iv- mos administrim të faturës për arkëtim për të ardhurat nga birësimet**

**v- administrimi i vlerave materiale nga nëpunësi autorizues** në kundërshtim me ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**2- Sistemi i prokurimeve publike rezulton të ketë një nivel të lartë risku ku nga auditimet** janë evidentuar shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Per prokurimet Publike” i ndryshuar, V.K.M nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu E, pika 2, a, “Blerjet me vlera të vogla” me ndryshime, i shfuqizuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për procedurën e blerjeve me vlera të vogla”, i ndryshuar, dhe Urdhërave të Ministrit të Financave “ Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400 000 lekë dhe më të vogël se 400 000 lekë pa tvsh”.

Nga auditimet e ushtruara te të gjitha subjektet gjetjet konsistojnë në:

- Mungesë e kërkesës së blerjes së mallit apo kryerjes së shërbimit,
- Mungesë të llogaritjes së fondit limit,
- Mangësi në përcaktimin e procedurës së prokurimit
- Mangësi në hartimin e rregjistrit të parashikimit të prokurimeve publike duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël
- Mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallit apo kryerjes së shërbimit dhe realizimit të kontratës.
- Plotësimi i urdhër prokurimit jo sipas formularit standart
- Arkivimin e dosjes së prokurimit jo sipas ligjit “ Për arkivën”

**3- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimi financiar konsiderohet me risk të lartë** për shkeljet e konstatuara në zbatim të:

- *ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*

-*ligjit nr. 9228, datë, 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*, të ndryshuar  
-*V K M nr 248, datë, 10.04.1998, “Për miratimin e planit Kontabël Publik të Organeve të pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe të njësive që varen prej tyre”*.

-*Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre ...”* i ndryshuar.

Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e evidencës kontabile, në mbajtjen e ditarëve, rregjistrimin e dyfishtë, mbajtjen e librit të madh e librat e tjerë ndihmës, veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore, rregjistrin të mjeteve kryesore, parregullsi në inventarizim duke bërë jo të besueshëm raportimin financiar.

**4- Sistemi i pagesave për personelin** rezulton të ketë një *nivel të lartë risku* që lidhet kryesisht me shmangie në zbatimin korrekt të akteve ligjore të kërkuara për këtë qëllim.

- Nga auditimi është konstatuar se ka mangësi në deklarimin e shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj Degës së Tatimeve për ndalesat në pagë për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.
- Përlllogaritje gabim të shtesave mbi pagë për dëmshmëri shëndeti, duke mos u azhornuar në kohë me legjislacionin
- Përlllogaritje gabim dietash në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 ”Për trajtimin Financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

## **5- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore paraqitet me *risk të mesëm*.**

Një nga mangësitë kryesore të këtij sistemi është ndarja jo e qartë e roleve dhe përgjegjësi që tregon për dobësi në vetë sistemin e kontrollit të brendshëm.

## **6- Sistemi i Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit**

-Raportimi për masat e mara nga ana e titullarëve të subjekteve të audituara është i mangët në caktimin e afateve dhe përgjegjësive gjithashtu dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

-Ka mangësi në inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit sipas ligjit për arkivën.

## **V - Gjetjet kryesore sipas sistemeve**

### ***1-Në sistemin e zbatimit të buxhetit***

**a-** Janë konstatuar shkelje të ligjit “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” në ***lidhje me ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit.***

Gjithashtu projekt buxheti ***nuk është hartuar i detajuar me mallra e shërbime*** konkrete që përbën bazën për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike. ( DR SHSSH Berat, DR SHSSH Fier, DR SHSSH Korçë, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër)

***b-mangësi në justifikimin e shpenzimeve të kryera me dokumentacionin autorizues dhe vërtetues,***

-Janë likuiduar operatorët ekonomikë pa dokumentuar marrjen në dorëzim të shërbimeve apo marrjes në dorëzim të mallrave sipas Udhëzimit 30 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Drejtoria Rajonale SHSSH Fier, Berat, Korçë, Shtëpia e Foshnjës Durrës.

### **c Në menaxhimin e aktiveve**

- në ***mungesën e rregjistrit të aktiveve*** sipas Udhëzimit nr.30 të Ministrit të Financave, Drejtoria Rajonale SHSSH Fier, Shtëpia e Foshnjës Durrës.

- ***në kryerjen e procedurës së inventarizimit*** jo në përputhje me Udhëzimin 30, “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Drejtoria Rajonale SHSSH Fier, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë.

-***administrimi i vlerave materiale, karburantit,*** nga nëpunësi autorizues në kundërshtim me ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “, Shtëpia e Foshnjës Durrës.

-Mangësi ***në justifikimin e shpenzimeve për karburant,*** në fletë udhëtim nuk përcaktohet se ku shkon mjeti, arsyen e lëvizjes, personi udhëtues, përlllogaritjen në lidhje me sasinë e marrë të karburantit dhe atë të shpenzuar sipas kilometrave të përshkruara: Shtëpia e Foshnjës Durrës.

-***Nuk janë respektuar kuotat*** e shpenzimeve për ushqime për përfituesit ditorë që trajtohen në qendrat rezidenciale, sipas udhëzimit nr 5 datë 01/08/2012 të MPCSSHB, duke i përlllogaritur më pak: Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër.

## 2 - Sistemi i pagesave për personelin rezulton të ketë një nivel të lartë risku

*i- Në mos deklarimin dhe likuidimin në kohë të detyrimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimin* duke krijuar rritje të shpenzimeve nëpërmjet pagesës së interesave e gjobave, ( Drejtoria Rajonale SHSSH Tiranë, 164,742 lekë principlial dhe 130,416 lekë gjoba e interesa)

*ii-Përlllogaritje dietash në kundërshtim* me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin Financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" në vlerën 4.500 lekë Drejtoria Rajonale Berat ( 1 person)

*iii- Përlllogaritje gabim të shtesës për dëmshmëri shëndeti*, duke mos reflektuar në kohë ndryshimet e akteve në fuqi, në Shtëpine e Foshnjës Durrës, Shtëpinë e Foshnjës Shkodër.

### 3-Shkelje janë kostatuar në *sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar*, si:

- mangësi në regjistrimin e transaksioneve, shmangie nga standardet e miratuara, dokumentimin e transaksioneve të mbylljes, mbajtjen e librave ndihmës, evidentimin e kreditorëve e debitorëve dhe ndjekjen e tyre: Drejtoria Rajonale Tiranë, Shtëpia e Foshnjës Durrës.

### 4-Në *sistemin e prokurimeve publike*:

-Plotësimi i regjistrimit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve jo sipas standarteve, DR Fier, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër.

- mungesë të kërkesës për prokurim, të administrimit të llogaritjes së fondit limit, DR Fier, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër.


-Mosndjekje e realizimit të kontratës sipas sasisë së artikujve të kërkuar, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër

-mungesë të marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve e hartimi i raportit përmbledhës së realizimit të kontratës, DR Rajonale, Fier, DR Berat, DR Korçë, Shtëpia e Foshnjës Durrës.

- përzgjedhje e procedurës së prokurimit në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit, Shtëpia e Foshnjës Durrës

- Mos Arkivimi i dosjes së prokurimit sipas ligjit për arkivën, Shtëpia e Foshnjës Durrës, Shtëpia e Foshnjës Shkodër

Gjetjet në vlerë në mënyrë grafike paraqiten si më poshtë.



### -Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga auditimi i veprimtarisë në 8 subjektet e audituara janë konstatuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm që kanë lidhje me:

- ndarjen e përgjegjësive në proceset e ndryshme për caktimin e urdhëruesit, zbatuesit dhe monitoruesit.

- hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre,
- Rregulloret e funksionimit janë përgjithësuese dhe jo të detajura me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për cdo person, të cilat janë rishikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ShSSH.
- Mangësi në inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit në institucion kjo për shkak të ambienteve, strukturës ( nuk ka punonjës arkivist e protokollist).

## **V. Rekomandimet.**

### **- Rekomandimet e propozuara.**

Nga ana e auditëve për cdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen. Për 8 subjektet e audituara janë lënë **gjithsej 75 rekomandime, afërsisht 9.3 rekomandime për subjekt**. Rekomandimet janë lënë për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë së subjektit me qëllimin menaxhimin e riskut.

**a-Për përmirësimin e sistemit të prokurimeve** janë lënë rekomandime për parashikimin e detajuar të nevojave për mallra e shërbime duke përfshirë dhe blerjet me vlerë të vogël, mbajtjen parasysh të mangësive të trajtuara në zhëllimin e procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël, për administrimin e kërkesës për nevojën e tyre, miratimin, përcaktimin e fondit limit, ndjekjen e realizimit të kontratës, marrjen në dorëzim të mallrave e shërbimeve.

**b-Në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit** janë lënë rekomandime për përmirësimin e procesit të hartimit të buxhetit nëpërmjet ngritjes së një grup pune për përcaktimin e nevojave për mallra e shërbime në mënyrë të detajuar me qëllim arritjen e objektivave të subjektit me ekonomi, efencë, efektiëtet.

- Në sistemin e zbatimit të buxhetit janë lënë rekomandime për përmirësimin e sistemit në lidhje me rishikimin nga nëpunësi zbatues të dokumentacionit shoqërues justifikues, autorizues e vërtetues, para kryerjes së pagesës së shpenzimeve.

- moslikuidimin e operatorëve ekonomik pa u kryer e marrë në dorëzim malli e shërbimi.

**c- Në sistemin e pagesave të stafit** janë lënë rekomandime për eëdentimin e kohës së punës, kthimin e të gjithë përfitimeve të padrejta nga përlllogaritje të gabuara të pagave dhe shtesave mbi to.

**d- në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar** janë lënë rekomandime për:

- **mbajtjen e evidencës kontabile**, ditarët, librat ndihmës, rregjistrimet e transaksioneve sipas rregullave e standarteve në fuqi.

-**Hartimin e regjistrit të aktiveve** si përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26-29.

-**Përmirësimin e procedurës së inventarizimit**, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi.

**e- Në sistemin e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore** është lënë rekomandim për administrimin e dosjes dhe regjistrin të personelit, dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe aktiveve për punonjësit që largohen dhe ata që fillojnë punë në subjekt, ndarjen e përgjegjësiëve.

**f- Në sistemin e informacionit** është lënë detyrë për raportimin herë pas herë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi sipas afateve të përcaktuara, arkiëmin dhe inventarizimin e dokumentacionit sipas rregullave në fuqi.

Majlinda Lako, Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit